



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I PERFORMANCËS SHËNDETIT PUBLIK DHE SËMUNDJEVE
KRONIKE

PERMBLEDHJE E HASJES SE KANCERIT TE GJIRIT NË SHQIPËRI PER VITIN 2023

Kanceri i gjirit është kanceri me shpeshësinë më të lartë jo vetëm mes femrave por madje edhe në popullatën e përgjithshme, në shumicën e vendeve të botës. Për numrin total të rasteve të reja të diagnostikuara në botë në vitin 2022 renditej i dyti pas kancerit të mushkërive, ndërkohë që zinte vendin e katërt përta i përket numrit të vdekjeve të shkaktuara këtë vit.

INCIDENCA E KANCERIT TË GJIRIT NË SHQIPËRI

Pamja epidemiologjike e kancerit të gjirit në vendin tonë është shumë e ngjashme me mesataren e popullatës së botës. Ashtu si në nivel global, edhe në Shqipëri, kanceri i gjirit përbën më shumë se 11 % të të gjitha rasteve të reja me kancer të diagnostikuara çdo vit, ndërkohë që vlerësohet se rreth një e katërta e të gjitha grave në popullatën që jetojnë me një neoplazi malinje, kanë kancer gjiri.

Kanceri i gjirit në Shqipëri është kanceri më i shpeshtë në popullatën e përgjithshme së bashku me kancerin e mushkërive. Në terma të riskut (në përpjestim me popullatën që e prodhon sëmundjen) kanceri i gjirit është kanceri me riskun më të lartë në Shqipëri, në distancë nga kanceret e tjera.

Në vitin 2023, u diagnostikuan 744 femra me kancer të gjirit në të gjithë vendin ose 61.4 për 100,000 femra. Në 2023 u diagnostikuan gjithashtu edhe 15 kancere gjiri te meshkujt.

Deri në llogaritjen e projeksioneve të reja retrospektive bazuar në Censin 2022, është e vështirë të analizohet prirja e incidencës në vite, por numri absolut i rasteve të diagnostikuara në 2023 është në mënyrë domethënëse më i lartë se ai i raportuar në 2022 (4.8%). Kjo mund të jetë vetëm pjesërisht shprehje e kompensimit të numrit të ulët të raportuar në vitin pandemik 2020.

Duke analizuar numrin e rasteve të diagnostikuara çdo vit me kancer gjiri, vërehet një rritje e lehte graduale nder vite.

Në raportin e vitit të kaluar është paraqitur prirja e incidencës së standartizuar sipas moshës (një tregues që shmang efektin e ndryshimeve moshore të popullatës me kalimin e kohës). Standartizimi është kryer bazuar në popullatën standarte të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (WHO standard population 2000-2025). Kjo analizë dëshmonte se incidenca mbetet përgjithësisht e qëndrueshme në vite, nëse do të shmangnim efektin e rritjes së moshës mesatare në popullatë. Megjithatë mbetet të verifikohet sërish kjo prirje pas prodhimit të projeksioneve retrospektive bazuar në Censin 2023.

Theksojme se vlerësohet të jenë rreth 5,000 gra që jetojnë me Ca e gjirit në vendin tonë.

Risku për t'u diagnostikuar nga kanceri i gjirit rritet me moshën deri në 70 vjeç. Risku maksimal është në moshën 50 deri 70 vjeç. Pas kësaj moshe vërehet një rënie. Risku është shumë i ulët por jo zero në moshën 20-30 vjec.

Mosha mediane e rasteve të reja në momentin e diagnozës është në 57,6 vjeç në vitin 2023. Rritja e moshës mediane është një prirje e ndikuar nga rritja e moshës mesatare të popullatës apo **“plakja”** relative e popullatës dhe raportohet kudo në botë.


Vërehet gjithashtu se vëndet me popullatë më të plakur e kanë moshën mesatare si të vdekjeve ashtu edhe të incidencës së kancereve më të lartë se sa vendet me popullatë më të re. Ky efekt është më i fortë se prirja për ulje të moshës së diagnozës si pasojë e ndërgjegjësimit më të madh të popullatës.

Më shumë se 75% e rasteve të reja në vitin 2023 (73% në vitin 2022) janë diagnostikuar mbi moshën 50 vjeç. Edhe në këtë rast vërehet një rritje e proporcionit të rasteve të diagnostikuara mbi moshën 50 vjeç, me kalimin e viteve.


Në analizën e shpërndarjes hapësinore, incidenca duket të jetë më e lartë në qarqet e Korçës, Beratit, Lezhës dhe Elbasanit dhe më e ulët në Kukës, Vlorë dhe Shkodër. Rreth një e treta (32.3%) e gjithë rasteve të reja janë nga Tirana, ç`ka reflekton përmasat e popullatës të Tiranës në totalin e popullatës rezidente të Shqipërisë në Censin 2023.

Në figurat e mëposhtme janë paraqitur të dhëna më të detajuara nga Regjistri Kombëtar i kancerit lidhur me shpërndarjen e kancerit të gjirit në vendin tonë sipas moshës e gjeografisë.

Incidenca (për 100 000) e kancerit të gjirit te femrat sipas grup-moshës 2023




Incidenca (/100 000) e kancerit të gjirit te femrat sipas qarqeve 2023



Incidenca e standartizuar sipas moshës e kancerit të gjirit në Shqipëri konsiderohet mesatare në nivel global por ende ndër më të ulëtat në Europë.

Niveli i incidencës së standartizuar sipas moshës për kancerin e gjirit në Rajonin Evropian



GLOBOCAN 2022 (8.2.2024) International Agency for Reserach on Cancer (IARC) (WHO)

DEPISTIMI ME MAMOGRAFI

Në zbatim të treguesve të Planit Kombëtar të Kontrollit të Kancereve, duket se për të rritur numrin e mamografive depistuese duhen më shumë përpjekje për të bindur gratë të kryejnë mamografi gjatë muajve të tjerë të vitit, jashtë fushatës së Tetorit Rozë.

Të gjitha gratë marrin kontaktin e parë me mjekun e familjes dhe/ose infermieren e qëndrës shëndetësore me qëllim informimin rreth rrezikut për kancerin e gjirit, duke kryer dhe ekzaminimin klinik me palpim të gjirit.

Gratë e grup moshës 50 – 60 vjeç ose grup moshë të tjera në risk, ftohen dhe udhëzohen nga mjeku i familjes për të kryer ekzaminimin me mamografi. Depistimi me mamografi kryhet çdo dy vjet për gratë që rezultojnë pa probleme ose dyshime të mundshme. Shërbimet e diagnozës së mëtejshme dhe të trajtimit eventual mjekësor ofrohen për të gjitha gratë që rezultojnë pozitive në depistim pas kryerjes së mamografisë. Shërbimet ofrohen pa pagesë në shërbimin spitalor publik, duke zbatuar sistemin e referimit.

Vetëm mamografitë e lëvizshme çdo vit arrijnë të identifikojnë më shumë se 10 raste të mundshme kanceri, ndërkohë që shumë gra të tjera ndiqen për të përjashtuar mundësinë e kancerit. Të gjitha mamografitë depistuese në vit ndihmojnë në identifikimin e hershëm të të paktën 50 rasteve me kancer gjiri.